

INTERVISTË ME RAMIZ KELMENDIN

Prishtinë | 12 qershor dhe 10 korrik 2014

Kohëzgjatja: 33 minuta

Të pranishëm:

1. Ramiz Kelmendi (I intervistuari)
2. Anna Di Lellio (Intervistuesja)
3. Donjeta Berisha (Intervistuesja/Kamera)
4. Jeta Rexha (Intervistuesja)
5. Migjen kelmendi (Intervistuesi)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } – i/e intervistuari/a shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje

[Intervista është montuar nga Migjen Kelmendi]

Jeta Rexha: A mund të na tregoni diçka për fëmijërinë tuaj?

Ramiz Kelmendi: Paj, si fëmijëria e krejt gjeneratës sime, nuk ka qenë fëmiri për t'u lakmuar. Kishte skamje t'madhe, ishim edhe t'shtypur edhe t'shkelur edhe t'lanë pas dore. Unë kom lindur edhe jom rritur n'Pejë, por me origjinë jom nga Rugova, me babë dhe me nanë dhe krenohem që po rrjedh prej andej. Po, e gjitha që mund t'them osht' që sidoqoftë nuk mund t'mos jem i knaqur me jetën që kom kalu'. Edhe n'fëmirinë time, pata fatin e mirë që e kisha babanë, e kisha ekonomikisht bukur mirë. Kishte një dyqan t'vetin. Na ka rritur e ngritur gjashtë djemë e dy vajza, tetë fmi i kishte baba ime e nana ime. Të tetët kanë mbaruar shkollën, edhe kjo osht' një mburrje për babanë time edhe nanën time që të dy kanë qenë pa shkollë. Se ishte shkolla kur gati nuk shkolloheshin fmitë shqiptarë. Edhe n'qoftëse shkonin n'shkolla, i çonin nëpër mejtepe, kanë qenë shkolla fetare i qujshin mejtepe. Po me kohë pastaj, me kohë natyrisht duke lexuar libra, duke rënë n'kontakt...

Ne e patëm fatin e mirë, unë edhe gjenerata ime patëm fatin e mirë qi nërkohë pas '41-shit, edhe erdhi Shqipëria edhe u bo Shqipëria e madhe dhe ne fitum njifar lirie. Na erdhën libra nga Shqipëria. Filluam t'edukoheshim me ato libra qi na vinin. Unë ma shumë se shkolla, mu m'ka eduku', m'kanë eduku' librat. Nga e kom pasë atë prirje, dashuri për leximin e librave nuk e shpjegoj për arsye se edhe babanë edhe nënën i kom pasë pa shkollë, asnjë ditë shkollë. Isha... isha i dhënë pas librave qysh si fmi. Edhe e kom pasë një nga frymëzimet e para për leximin e librave shqip, ka qenë "Gremina e Dashurisë" e Mustafa Greblleshit. Edhe prej atëherë, unë çka kom gjetë libra në librari, kishim dy librari n'Pejë, t'gjithë librat që n'a vinin nga Shqipëria une i bleja edhe i lexoja. Po flas për periudhën '41-'44. Dhe, leximi i librave m'bëri mua ky që jam.

I dashuruar për leximin e librave, unë kadal – kadale fillova edhe vet t'shkruaj. Fillova t'shkarravis, botova librin e parë, "Vija e Vragë", pastaj me radhë, "Shtatë persona ndjekin autorin." S'e di unë, s'e di sa libra kom botuar, shumë. Edhe bashkëpunova me një revistë, ishte "Zëri i Rinisë" atëhere, fillum si studentë,

fillum n'Beograd t'a botojmë atëhere revistën “Zëri i Rinisë”. Unë shkrova aty, isha redaktor, edhe prej aty filloi kjo ambicia ime edhe dëshira ime me u marrë me gazetari. Pastaj, m'morri “Rilindja” edhe punova n'gazetën “Rilindja” për shumë vjet me radhë, se shkrujsha. Dikur, m'emërun edhe drejtor t'shpisë botuse “Rilindja”. Fillova me u marrë edhe me botimin e librave edhe m'bonë drejtor të... domethonë, ktu Komiteti vendoste për fatin tonë.

Për kah letërisë e gazetarisë, unë jom marrë edhe me teatrin, aq sa bile njo katër vjet kom qenë drejtor i Teatrit Krahinor, m'bonë drejtor t'Teatrit. Dhe, n'Teatër hapa dy skena, dy skena që s'i kishte Teatri atëherë. Hapa Teatrin e Migjenit ku lexoheshin poezi, dhe Kabareu Satirik, ashtu e qujta unë – Kabareu Satirik, ku recitoheshin edhe diskutoheshin tema letrare kryesisht.

Maj n'mend që kom shkru' ma t'parin tregim n'jetën time “Barka e Peshkatarit”. Isha n'Ulqin, kisha një aventurë të themi rinore (buzëqeshë) me një ulqinake, dhe ajo m'frymëzoi, jo vetëm t'a shkruj tregimin e parë “Barka e Peshkatarit”, që e pata frymëzim nga ajo, por edhe t'merrem me letërsi. Se shkrova pas asaj, shkrova “Letra nga Ulqini”. Ulqini m'bëri shkrimtar t'a them t'drejtën.

(Buzëqeshë) Unë e kom një episod t'kohës t'Luftës kur ishin italianët. Oficerët italianë qi erdhën, qi e okupun bashkë me gjermanët, po italianët metën aty për arsye se familjet shqiptare, oficerët italianë nuk i pranonin n'shpjia t'veta për punë t'fesë edhe për punë të... ça di une, konservatorizmit. T'gjithë oficerët italianë banonin te femrat, te familjet serbe n'Pejë, edhe malazeze. Na kishim n'Pejë shumë serbë edhe malazezë. Edhe oficerët italianë, kryesisht e kalunë krejt okupacionet që i kishin n'Pejë, e kalunë n'familje serbe. E tash, duke banuar n'familje serbe, n'familje serbe natyrisht që kishte edhe vajza t'lakmushme. Edhe me kohë pastaj, bile, duke bashkëjetuar këta oficerët italianë me femnat serbe që i kishim fqinje krejt aty, se n'Pejë ka shumë serbë edhe malazezë, sidomos malazezë... Na qëllloi njo dy herë ditën e pazarit, dita e pazarit osht' dita e tregut n'Pejë, dita e shtune, që për shembull na erdh Mustafa Kruja. Mustafa Kruja ka qenë atëherë kryeministër edhe shkrimtar, por edhe pushtetar i madh, edhe erdh për vizitë n'Pejë. Ishte si kryeministër, çfarë ishte. Edhe kur dolëm ne, ne bërtitshim “Kruja, Kruja, Kruja!” {rrahë duart – improvizon thirrjet}. Po atë ditë na ndodhi paradite “Kruja, Kruja!”, masdite “Kruju, kruju” (qeshje). Pse? Oficerët italianë që banonin në familje serbe, se asnji familje shqiptare s'ka marrë oficerë italianë me banu' n'shpi t'vet, se na kishim fe demek që na ndalonte.

Donjeta Berisha: Pse vendosët t'shkonit t'studionit n'Beograd?

Ramiz Kelmendi: Po n'Beograd për arsye se ishte dega e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, ishte katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe me profesor Vojsllav Dançetoviçin edhe me dy asistenta – Idriz Ajetin edhe Anton Çetën. Edhe unë u regjistrova n'katedrën, quhej katedra e Albanologjisë e Gjuhës Shqipe, Gjuhës Letërsisë Shqipe. Edhe shkova, natyrisht u regjistrova për Gjuhë e Letërsi edhe i marova studimet në Beograd te Vojsllav Dançetoviçi, ishte shef i katedrës, por ishin profesorë edhe Idriz Ajeti dhe Anton Çetta. Edhe aty i kom kry studimet e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe – katër vjet.

Donjeta Berisha: Pastaj jeni kthi n'Kosovë?

Ramiz Kelmendi: Pastaj, jom kthy në “Rilindje”, se “Rilindja” ma dha bursën, unë shkruajsha, isha gazetar. Dhe “Rilindja” edhe ma dha stipendinë, edhe m’morri posa u ktheva edhe punova dhetë vjet kom punu’ si redaktor në “Rilindje”, si gazetar. Jom nga gazetarët ma t’vjetër n’Kosovë.

Donjeta Berisha: Si ka qenë jeta n’Beograd?

Ramiz Kelmendi: Po si ta them... jetë studentore - jetë studentore. Ma interesantja ishte qi na u dha mundësia, na u dha mundësia, unë e dojsa Gjuhën e Letërsinë Shqipe, na u dha mundësia që midis Beogradit, t’hapet katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe. Ia di për borxh kësaj katedres se unë u orientova krejt tjetër, u orientova kah Letërsia dhe Gjuha Shqipe, e aty n’katedër kishim bibliotekën ma t’pasun t’librit n’shqip, që kishte pru Vojsllav Dançetoviçi nga Tirana, shefi i katedrës. Por, edhe n’Beograd andej u botu’, se patëm botu’ edhe kte “Zërin e Rinisë”. Një herë ishte revistë e asaj kohe “Zëri i Rinisë” e qujshim, edhe n’reaksi ishte Gjon Shiroka, Musa Murtezai kryeredaktor, Murat Morina, Rexhep Surroi dhe unë. E na fillum me botu’, n’Beograd fillum me botu’ revistën “Zëri i Rinisë” dhe aty me “Zërin e Rinisë”. Faktikisht unë hyra n’gazetari dhe kur i marova studimet, “Rilindja” edhe ma dha bursën, edhe u ktheva në “Rilindje”, edhe u bëra reporter i lirë me thanë, reporter i lirë domethonë gazetar që shkrun tema t’lira, jo qi osht’ kallëp. Dhe prej aty, si me thanë prej atëherë u bona gazetar profesionist.

N’viti n’45 domethonë isha 15 vjeçar unë se jom në t’30-tën i lindur, kisha tmerrisht dashuri t’madhe për atdheun, për Shqipërinë. E doja Shqipërinë shumë, aq sa një grup nesh nxanësa, por sot janë emra t’njohur, e formum një grup anti-jugosllav, anti-serb, një grup shqiptarë t’cilët ishin për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë dhe e donim Shqipërinë. Kjo ka qenë n’viti 1945 kur isha 15 vjeç, dhe e formum një grup, një organizatë t’a themi ilegale, një pesë-gjashtë shokë. Njëri nga ata që ishte n’grupin tonë, m’duket na tradhëtoi, dhe na burgosën. Mu m’kanë burgosë n’moshën 15 vjeçare. M’ka burgosë UDB-a e Pejës, mu me shokë. Edhe na majtën n’burg n’Pejë, pastaj Prizreni ka qenë kryeqendra e Kosovës atëhere, dhe na çunë n’Prizren. N’Prizren na lidhën me grupin e Marie Shllakut. Marie Shllaku ka qenë një heroinë nga Shkodra e cila ka jetu’ n’Kosovë edhe ka punu’ n’Kosovë edhe ka luftu’ n’Drenicë me pushkë n’dorë, një trimreshë. Unë kom ba librin “Shqipëria e Marie Shllakut”, na lidhën me Marie Shllakun, na nxorrën n’gjqy publik n’Prizren.

Ne ishim pesë-gjashtë shokë që e nxorrëm një revistë anti-komuniste, anti-serbe dhe na burgosën. Prizreni ishte kryeqendra e Kosovës, n’a nxorrën n’Pallatin e Kulturës n’gjqy publik. Ali Shukriu ishte prokuror, ai na gjykoi, na dënoi, n’grupin tonë ishte Marie Shllaku por edhe Bernard Llupi prifti i Pejës, Gjergj Martini një shkodran, edhe Kolë Parubi poashtu profesor i joni i Gjuhës Shqipe.

Na burgosën, kta katër ku ishte n’krye Marie Shllaku, femën për t’cilën kom ba një libër unë, “Shqipëria e Marie Shllaku”. Marie Shllaku, Bernard Llupi prifti, Kolë Parubi profesor i Gjuhës Shqipe, edhe Gjergj Martini u dënuan me pushkatim. Dënoi Ali Shukriu, ishte prokuror n’Prizren, n’gjqy publik. Ata u dënuan me pushkatim, ne që ishim voglushë ishim 15 vjeçarë, unë isha 15 vjeç, ne na dënuan nga një vit burg.

Donjeta Berisha: N’cilin burg keni kalu’ kohë ma tepër, e keni vujtë dënimin?

Ramiz Kelmendi: N'burg t'Prizrenit. Gjithmonë e kom pasë atë damkën {grushton shuplakën} sa ishte komunizmi, sa ishte t'a themi Jugosllavia. Unë e kom pasë damkën {grushton shuplakën} që jom i burgosur politik edhe që jom nacionalist, se une e dojsa Shqipërinë natyrisht.

Donjeta Berisha: A ju ka ndiku' në t'ardhmen kjo n'punë kur keni dalë mas burgut?

Ramiz Kelmendi: Ka ndiku' shumë.

Donjeta Berisha: Cilat jonë pasojat?

Ramiz Kelmendi: Po pasojat, se kishin qëndrim shumë t'keq ndaj meje. M'konsiderojshin nacionalist që do t'thotë armik të Serbisë, t'Jugosllavisë e t'komunizmit. Edhe unë isha me t'vërtetë armik i komunizmit edhe armik i Serbisë edhe kom pasë probleme. Mirëpo, çka m'ka pshtu' mu, mu m'ka pshtu lapsi.

Babën e kisha tregtar edhe e qujshin "ratni bogataš" domethënë pasanik i luftës. Edhe serbët e konsiderojshin nacionalist se unë me një grup shokësh e nxorrëm revistën "Drita e Lirisë", një revistë anti-komuniste, anti-serbe.

Donjeta Berisha: Mandej ju keni apliku' për bursë. Për çfarë burse keni apliku' që iu ka refuzu'?

Ramiz Kelmendi: Po aplikova për bursë me studiu n'Beograd, nuk m'dhanë edhe unë fillova me qajtë. M'gjetei baba para dere t'u qajtë. "Çka ke baba?", baba im punonte me kuaj, çonte postën n'Pejë, e çonte prej stacionit edhe i binte. Na mante tetë fmijë, gjashtë djemë e dy vajza. Thashë "Po qaj babë se s'ma kanë dhonë stipendinë". Tha "Çka s'të kanë dhonë?" se ai s'dijke baba se çka osht' stipendia. Po i thashës "S'më kanë dhonë bursë", "Çka je t'u thonë?" m'tha, i thashë "Po s'mkanë dhonë pare për me studiu!". "Ani" tha, "për qito po kanë a?" Ai ish... punonte me kuaj, edhe i ra kuajve me dorë, dy kuajve, "Une i shes kuajt, e shes shpinë, ti k'i me shku' me studiu". Edhe m'çoi n'studime baba.

Babën e kisha "ratni bogataš" i thojshin, pasanik i luftës, ishte tregtar baba. Edhe e patën burgosë babën tim, UDB-a e pat burgosë. Edhe e konsiderojshin krejt familjen armiqsore, që jena kundër komunistave. Dhe kur erdh puna me kërk'u stipendi, mu nuk m'a dhanë stipendinë se thanë osht' djali i armikut t'popullit. M'a patën burgosë babën si pasanik i luftës, ka qenë tregtar.

Donjeta Berisha: Për sa kohë e kanë burgosë? Për sa gjatë ka nejtë n'burg?

Ramiz Kelmendi: E çunë atje... ka ndejtë gati një vit besa, e çunë edhe n'Nish. E dënun me burg, edhe ia murrën krejt pasuninë. Ai ishte tregtar. Edhe e dënunë një vit a sa burg, babën.

Po me ne ishte edhe Isa Çavolli, msusi jonë, profesori. Dhe idea ishte ose synimi i Ali Shukriut që na gjykonte edhe ishte prokuror, ishte idea që krejt fajet tona, ne që ishim fmijë 15 vjeçarë – Viktor Gashi, Kamber Pajaziti, Ramiz Kelmendi, t'ja hidhnin fajet që kishin synim që t'a pushkatonin Isa Çavollin. Po Isa Çavollin nuk mund t'them se ka pasur ndonjë rol, por u dukej pak që kishin punë me fmi si isha unë 15

vjeçar. Dhe, krejt fajin tonë donin t'ja hudhnin Isa Çavollit sepse ishte e palogjikshme qi të dënohen me pushkatim siq e kishte planin Ali Shukriu dhe UDB-a e asaj kohe, për t'pushkatuar sa ma shumë armiqë popullit – Ballista quheshin. Krejt fajin donin t'ja hudhnin Isa Çavollit se s'kishte kuptim t'dënohej me pushkatim për shembull fëmitë si Viktor Gashi, Osman Basha, Ramiz Kelmendi...

E dënujë me vdekje, pushkatim, Marie Shllakun, Bernard Lllupin dhe Gjergj Martinin. Gjergj Martini ishte një msus n'Gjakovë nga Shkodra edhe ai. Por, Marie Shllaku u bë si t'thushë personi më i atakuar edhe personi i cili gati e morri krejt barrën e grupit që ishim anti-komunista, anti-serb.

Për shembull, m'kujtohet një detaj ta them kshtu, Ali Shukriu... unë paditesha se kisha bërë, ne e nxorrëm një revistë anti-komuniste, anti-serbe dhe kur erdhi puna ata donin që këtë revistë, këtë botim t'ksaj reviste t'ja hudhnin për t'a pushkatuar Isa Çavollin, t'atin e Liliana Çavollit. E s'mund t'a besonte Ali Shukriu se unë Shefqet Kelmendi e kush ishim, me fmi që kishin botuar revistë dhe dinin t'shkruanin. Për shembull m'a banin mu "Kush e ka shkru' kto?" "E kom shkru' unë". Tha, "Une i kom bo njizet vjet shkollë, s'i kom shkru' dy artikuj, ti i ke shkru!". Une i thashë, "Shok prokuror mos besofshi që i kom shkru' une, ma bini një letër." Gjykimi publik n'Prizren n'Pallatin e Kulturës. Thashë "Ma sillni një letër unë ju shkruj". "Une," tha "i kom bo njizet vjet shkollë s'i kom shkru' kto, ti i ki shkru!" (buzëqeshë). Une i thash, "Bjerma njihere, po ju bindi qitu që a di me shkru' a s'di me shkru'". "Ulu" tha "n'bankën e gomarëve more budallë!".

Migjen Kelmendi: A t'shajti a?

Ramiz Kelmendi: Po, po "N'bankën e gomarëve more budallë". Në t'njajtën kohë unë n'burgun e UDB-së ktu, babai ishte i burgosun në Kullën e Sheremetit. Ishin dy burgje atëherë, policia UDB-a i kishte. Nji, burgu kryesor sot në Akademinë e pikturës... t'Arteve në Pejë, dhe tjetri burgu i Sheremetit, te Kulla e Sheremetit, kshtu e quanin. Une e kisha babën t'burgosun n'Kullë t'Sheremetit e vet isha i burgosun në burgun e UDB-ës ktu.

Po t'gjithë ishim shqiptarë ose nga Kosova, ose nga Maqedonia, që i mbarum Degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe n'saje të Dançetoviçit. Thuj ti pse, po u hap Dega e Gjuhës e Letërsisë Shqipe n'Beograd n'Fakultetin Filozofik. Vetëm e vetëm për t'i gjetë vend kujt? Vojsllav Dançetoviçi i cili vinte nga Tirana. Vojsllav Dançetoviçi osht', jetoj kohë t'gjatë n'Tiranë edhe s'e di edhe atje bëri bukur punë. Edhe për fjalor edhe për gjuhë, aq sa kur e prunën, e prunën shef Katedre të Degës... ai e hapi Degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe dhe mori asistent Idriz Ajetin edhe Anton Çettën. Edhe ne... unë që e doja Gjuhën e Letërsinë Shqipe, pa u hamendur fare drejt e u regjistрова, bashkë me shumë kolegë, shokët e mi.

Po bëmë, bëmë Klubin Letrar, edhe çdo javë kishim po, ne studentët çdo javë mbanim një si orë letrare në Katedrën e Gjuhës e Letërsisë Shqiptare. Dhe, Katedra e Gjuhës e Letërsisë Shqipe u ba njëfar dore stimulare, si t'a them si... organizatore e një veprimtarie shumë pro-shqiptare. Nga e morrëm këtë, edhe ushqimi im për shembull, nga erdhi? Unë jo rastësisht e kom pagëzu' djalin tem të dytin me rradhë mas Migjenit, Visar. Pse? Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, Dançetoviçi kishte sjellë nga Tirana një bibliotekë shumë t'pasun t'librit. Unë n'fakt ma shumë kom msu' edhe ia di për ner ma shumë asaj

bibloteke që e solli Dançetoviçi nga Tirana në Degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Fakultetin Filozofik jugosllav serb n'Beograd, se ç'kom msu' nga shkolla, kom harru'.

Ky na solli se “Visaret e Kombit” ishte një koleksion, një koleksion jo po si t'a them një bibliotekë me titullin “Visaret e Kombit”. N'atë kolanë librash me titull t'përbashkët “Visaret e Kombit”, ishte letërsia popullore dhe fjala visaret e kombit, visar aq më pëlqeu ajo visaret e kombit domethonë pasuria e kombit. Unë s'e dijsa çka domethonë fjala visar, pastaj e msova derisa e pagëzova djalin tim se ju kte nuk e dini. E pagëzova djalin tim të dytë me radhë, pas Migjenit që e kisha idhull, e kisha poetin ma t'madh ma t'dashtun, para Naimit e para kujt t'them... s'kishim atëherë Filip Shiroka e s'kishim shkrimtarë. Une e kisha Migjenin.

Me 25 maj 1955, une isha 25 vjeçar. Me 25 maj, n'mëngjes n'atë katedrën, në njërën nga klasat e katedrës ku ekzistonte Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, n'Fakultetin Filozofik t'Beogradit, isha ulur me dy studentesha nga Gjakova. Edhe pa vonuar shumë, derisa ne lexonim a bisedonim çka di unë, hapet dera dhe dy ftyra t'mrrolura, dy surrate thonë “Ramiz Kelmendi?” Thashë, “Ja [Unë]”, “Menjiherë me ne”. M'kapën për krahësh, m'zbritën, Katedra e Gjuhës ka qenë n'katin e katërt t'Fakultetit Filozofik n'Beograd. Zbres poshtë edhe barica poshtë, quhej barica automobili i policisë serbe. Edhe e kom bo njifar humori t'zi diku, e kom shkru' e kom botu'. Edhe m'futën mrena fillikat vetun ma mbyllën derën. Mirëpo, xhami i atyre shoferëve... shoferëve... i atyre UDB-ashve që m'burgosën ishte i hapur edhe ata flisnin. Edhe tash e kom bërë një humor t'zi unë diku e kom botuar, mu po m'çojnë n'burg po m'burgosin. Tonë kohën t'u bisedu' ata ndër veti “A ke qenë sot n'pazar? Sa bojshin specat? Sa bojshin kastravecet?”, edhe une e kom shkru' e kom bo një ironi kshtu, një humor t'zi me faktin se unë isha po hija n'burg po burgosësja e ata flisnin për sene t'rëndomta, sa bojshin specat... çka kish e çka s'kish.

Kur m'futën me një, ishte një dhomë e madhe me një pod si ky ktu {tregon me duar}, pastaj ishte dysHEMEJA, podi i çumë naltë edhe m'fusin në një dhomë ku s'isha vetëm, ishin edhe nja dhjetë tjerë. Ma vonë pastaj kuptova kush, filozofi Dada i famshëm e din ti duhet ta njohish {i drejtohet Migjenit}.

Migjen Kelmendi: Ai osht' piktori Dada.

Ramiz Kelmendi: Piktori Dada, po. Edhe piktur ka qenë, po edhe filozof. Dada e plot tjerë. Domethonë une s'dita pse po m'burgosin, çka ka ndodhë ktu. Arsyeja – sot n'Beograd vinë Krushçovii me Bullganin në vizitë me shokun Tito mas grindjes që ka pasë me Bashkimin Sovjetik Tito-ja. Edhe kur po i themi... pse... se neni i njajtë si ai, si ky, si prozagjia, si filozofi, si Ramizi, si shqiptari. Për çka pra me rujtë? Mos p'e vrasim na Ruçovin. Ishim t'rrezikshëm se UDB-a na konsideronte se jemi armiq. Edhe n'Beograd e nxorrëm revistën “Zëri i Rinisë”. N'redaksi ishim kryeredaktor Gjon Shiroka, redaktor Rexhai Surroi, Murat Morina edhe Ramiz Kelmendi. Edhe na fillum ta botojmë, Marshalla Tita 24 n'katin e katërt, na dhanë një zyre, edhe fillumë ta botojmë revistën “Zëri i Rinisë”... a.

Migjen Kelmendi: Zani!

Ramiz Kelmendi: “Zani i Rinisë” natyrisht!

Migjen Kelmendi: A ish gegnisht ajo?

Ramiz Kelmendi: Po gegnisht! S’ka pasë atëhere gjuhë letrare. Osht’ fjala për vitin ’55 kjo. Ne i botum disa numra të “Zërit t’Rinisë” në Beograd.

Lujti Shqipëria me Jugosllavinë futboll. Unë e kisha shumë mik t’madh Ramadan Vraniqin edhe sot i falemnderohem për s’vdekuri. Unë Ali Shala, Veli Vraniqi n’saje t’Ramadan Vraniqit, unë e kisha drejtor atëhere në “Zanin e Rinisë” n’a e bëri t’mundshme t’shkojmë ku luhej ndeshja Jugosllavi-Shqipëri futboll. Ramadani ishte kryetar i Lidhjes Futbollistike të Jugosllavisë por e kishim edhe drejtor të “Zërit”, por e kishim edhe mik. Edhe ja rasti, për herë të parë n’jetën time ta shoh atdheun tim dhe me plot knaqësi, me plot gzim i hypëm aeroplanit. Na e siguroi, na e rregulloi domethonë Ramadani me shku’ n’Shqipëri. Ishte ideali im, si me shku’ n’Qabe, baba s’u gzu’ sa u shku’ n’Qabe sa jom gzu’ une që kom shku’ n’Shqipëri. I hypëm aeroplanit edhe kem ardhë përmë aeroport t’Tiranës.

Na u soll aeroplani për sa minuta mi aeroportin e Tiranës edhe nuk po zbret. Edhe une veç që s’fillova me i ra grushta vetes {i bjen grushta kokës}, po thashë “A e ka shkru’ Zoti që me ardhë n’aerport t’Tiranës edhe mos me ateru’ për... ç’a po di, kushte klimatike?”. E u soll aeroplani njo dhetë-pesëmdhetë minuta n’aerport t’Tiranës, derisa aterum, zbritëm. A çka pashë? Mjerisht, s’sosht’ për t’u thanë po u zhgënjeva me shumëçka. Po nuk pashë çka pritsha unë, çka androjsja. Jo që s’pashë, po unë u zhgënjeva shumë, shumë, shumë me çka pashë. Nuk e pashë atë Shipni që e kisha imagjinu’ n’kokë, që e kisha idhull, që e kisha Qabe. Për mu Shqipëria ka qenë Qabe, po nuk pashë kurgjo që m’pëlqeu. Nuk m’pëlqeu sidomos... nejtse shkova n’Dajti, n’a çun n’Hotelin Dajti se krejt kjo ishte e organizuar. Unë shkova me futbollistët e kisha me veti edhe Veli Vraniqin, na bante humor. Na çun n’Dajti, puna e parë m’tha mu t’u hi, “Ki kujdes çka flet se krejt osht’...”

Migjen Kelmendi: E inçizume!

Ramiz Kelmendi: “Krejt inçizohet. Krejt osht’ e xhirume, e përgjume. Ki kujdes çka flet!”. E dyta, e kisha kte, unë e kisha edhe përpara këtë njohuri që Shqipëria osht’ sistemi komunist enverist, osht’ si ta them... nji diktaturë jo proletariatit, po e mutijatit si kurrkund tjetër në shtetet e Lindjes. Edhe isha i përgatitun çka m’pret atje n’Shqipëri. Natyrisht që unë e doja Shqipërinë, por nuk e doja Enver Hoxhën, kurrë s’e kom deshtë, s’e kom deshtë as atëherë kur shkova.

Na çunë n’Dajti, na vendosën, por kurrë nuk ishim vetun, gjithmonë e kishim hije nga nji njeri që na ndiqte, na përcillte. Unë pastaj e kom vërejtë se, une i parahatshëm m’ka falë Zoti, dojsja me pa sa shumë Tiranën. Edhe fillova me bredhë nëpër Tiranë e n’librari, e n’Pallatin e Kulturës, e kisha... Edhe vërejsha gjithmonë se t’paktën nji ose dy vetë {numron në gishta} e kisha gjithmonë përmas. As sa edhe kur hyra t’i qethi flokët, se në Hotelin Dajti ishte nji berbere, nji rrojtar. Edhe kur hyra me u qethë te ai rrojtar, po e vërej që njëri që gjithmonë disi m’vinte mrapa, erdhi edhe hyri edhe te berberi që ishte

n'Dajti, n'Hotelin Dajti. Domethonë m'ndiqte hap pas hapi. Ma kanë regjistru' domethanë, edhe ma thanë mandej, ma thanë kta që kur zore miqësi që "Ke qenë iurvejuar". Ata m'thanë, "Ju kemi përcjellë n'çdo hap". Po i thash, "Ju e dini që mu m'kanë konsideru' bile n'Kosovë qi jom krejt i Shqipërisë. Jom noshta spiun i Shqipërisë". "Po," tha "po ktu secili prej jush që ka ardhë, se nuk i shkrunte ktu {prekë ballin} se çfarë patrioti osht', secili prej jush ka qenë spiun i dërgum nga UDB-a, me ardhë me spiunu n'Tiranë, n'Shipni, kundër Shipnisë". Mu m'çunë, unë, Ali Shala {numëron në gishta} dhe Veli Vraniqi ishim.

Se unë shkova edhe për libra pastaj, solla libra nga Shqipëria, isha drejtor i shpisë botuse. Pruna libra, pruna kalendarë edhe pruna distinktiva, qaty e msova fjalën distinktiva. Disntinktiva i thojshin ata, znaçka na i thojshim kshtu "shqip" {bën shenjën e thonjëzave me duar}.

Migjen Kelmendi: Sa herë ke qenë n'Shipni babë?

Ramiz Kelmendi: Pesëmdhetë herë!

Migjen Kelmendi: Edhe?

Ramiz Kelmendi: Edhe pesëmdhetë herë sa here jom kthy une, kom rrejtë. Tanë i kom rrejtë, kushdo m'ka pytë, se ata kur kthehesha prej Shqipërie... une isha i privilegjuar, se shkova disa herë, pesëmdhetë herë shkova n'Shqipëri n'saje të Ymer Pulës që i çohem n'komë edhe sot për s'vdekuri, edhe Ramadan Vraniqit. Edhe sa here kom shku', une kur jom kthy, gjithmonë kom rrejtë cila osht' Shipnia. Se tonë lakmojshin, m'merrshin erë {i merr erë krahut}, me i ardhë erë Shpinie {prekë krahun} se e dini krejt Kosova, kosovarët jonë t'dhanun mas Shipnie – atdhe e kemi Shipninë.

Edhe kur kthehesha nga Shqipëria, po mlidheshin mas meje të vinin n'shpi e sende, "Tash m'i tregu' përshtypjet e... si e pashë Shqipërinë, e si osht' Shqipëria." Natyrisht që une kom rrejtë gjithmonë, se s'ishte as ngatë ajo Shipni për t'cilën flisja unë, Shqipëria e vërtetë.

Mu m'ka zhgënjy shumë Shqipëria e kohës së Enverit, ato pesëmdhetë herë që shkova, se nuk e kom pritë. Unë e kom andrru' Shqipërinë si Qaben hoxhallarët. E kom andrru' si diçka t'pagabushme edhe t'adhuruar që nji herë shihet n'jetë, edhe kurrë mo. Prej ditës t'parë që shkova, prej herës t'parë, e gjithë ato herët tjera që kom shku', une veç jom zhgënjy n'atë Shqipëri. Nuk m'ka... nuk m'osht paqësu' dashuria për atdheun si atdhe, por m'u pakësu' dashuria krejtësisht thuja për atë atdhe i cili ishte i komunistifikum me thonë. E unë isha kundër komunizmit sepse qai komunizëm n'Pejë mu m'burgosi. Isha i burgosur, anti-komunist. Gjithçka tjetër, pos Shqipëria si ide, Shqipëria si tempull, tempull i adhuruar unë nuk gjeta se gjeta shumë zhgënjim!